



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eteam" Sh.P.K. të datës 06.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në Milevic - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10598-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eteam" Sh.P.K. të datës 06.12.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në Milevic - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10598-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Eteam" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 06.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në Milevic - Ritender" me nr. të prokurimit 616-25-10598-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. - *“Kriteri që inxhinieri i ndërtimtarisë të posedojë certifikatat ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001 është i pajustifikueshëm, i paproporcional dhe në kundërshtim me praktikën profesionale”.*

P.2. - *“Kërkesa për punëtor të certifikuar njëkohësisht si hidroinstalues, ujësjellës, kanalizim dhe sanitar është e panevojshme dhe joproporcionale, pasi këto profesione zakonisht nuk certifikohen në një profil të vetëm”.*

P.3. - *“Kërkesa për posedimin e pajisjes “Makinë për shpuarje horizontale me sistem HDD, distance e shpimit 50 m” është e panevojshme dhe jorelevante në raport me natyrën e projektit, pasi në paramasat e këtij aktiviteti nuk figuron asnjë pozicion që kërkon shërbim të shpuarjes horizontale”.*

P.4. - *“Kërkesa për pajisjen “Gjysëmrimorkio me sistem hidraulik për tërheqjen e kabllove nëntokësore dhe ajrore” është e panevojshme dhe jorelevante për këtë projekt, pasi në paramasat e tenderit nuk figuron asnjë pozicion që lidhet me punime të ndriçimit, kabllove, instalimeve elektrike apo ndonjë aktivitet që kërkon tërheqje kabllore”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet cekur se inxhinieri i ndërtimit sipas P.1. është kërkuar të jetë po ashtu edhe menaxher i projektit. Përndryshe në gjithë këtë projekt është kërkuar vetëm 1 inxhinier i ndërtimit drejtimi konstruktiv dhe nuk janë kërkuar më shumë se një. Prandaj ky inxhinier si i tillë duke qenë se është edhe menaxher i projektit, të paktën duhet të jenë në përputhje me kërkesat për standardet e cilësisë. Në asnjë formë tjetër nuk mund të garantohej cilësia dhe standardi i kërkuar profesional i punimeve në këtë projekt. Në anën tjetër, standardet ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë absolutisht standardet më themelore të mundshme që duhet të përmbushen në çdo rast për projekte të tilla për të garantuar realizimin efikas dhe efektiv të projektit. Rrjedhimisht ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket kërkesës për punonjësin e certifikuar si hidroinstalues, duhet theksuar që parashtruesi nuk e konteston që një punonjës i kësaj fushe është i domosdoshëm për faktin që gjatë realizimit të projektit, punërkryesi mund të ballafaqohet me sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit por edhe me pjesën e drenazhimit të rrugës. Kontestimi i vetëm i parashtruesi është që këto profesione nuk certifikohen në këtë profil. Prandaj AK ka konfirmuar nëse ekzistojnë mundësi të certifikimit të hidroinstaluesve në Kosovë dhe me këtë rast janë gjetur më shumë se mjaftueshëm qendra të akredituara profesionale për certifikimin e profileve të tilla. Rrjedhimisht edhe ky pretendim është i pabazuar.

Ndërsa lidhur me pajisjet e kërkuara me DT të cilat potencohen sipas P.3 dhe P.4, bëhet fjalë për makineri themelore absolutisht të domosdoshme përmes të cilave do të realizohen punimet në këtë projekt. Prandaj edhe pretendimet për pajisje janë të pabazuara në tërësi.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime të pabazuara. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.